



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislacioni IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 69

Prishtinë, më 24 janar 2014, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-2

P r o c e s v e r b a l

I Mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Albin Kurti, Hydajet Hyseni, Sabri Hamiti, Skender Hyseni, Donika Kadaj-Bujupi, Emilija Rexhepi dhe Hamza Balje.

Munguan: Enis Kervan dhe Berat Buzhala.

Pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati-ZPRK dhe mediat.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Albin Kurti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d i d i t ë s:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 18 dhjetor 2013;
3. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Komisionit për vitin 2013;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Albin Kurti lidhur me rendin e ditës, theksoi se anëtarëve të Komisionit, në ndërkohë ju është shpërndarë një draft-plani dhe Program i Punës së Komisionit, duke pasur parasysh vendimin e Kryesisë së Kuvendit, se komisionet parlamentare, duhet të hartojnë planet e tyre të punës deri më 29 janar 2014. Ai propozoi që rendi i ditës të plotësohet edhe me këtë pikë.

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës, të plotësuar pas pikës 3, edhe me pikën:

4. Shqyrtimi i Planit dhe Programit të Punës së Komisionit, për vitin 2014.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 18 dhjetor 2013;

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi njëzëri procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 18 dhjetor 2013.

3. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Komisionit për vitin 2013;

Albin Kurti theksoi se në raportin e përgatitur për punën e Komisionit gjatë vitit 2013, është përfshirë në pika të shkurtra i gjithë aktiviteti i Komisionit, gjatë vitit të kaluar.

Pas diskutimeve, lidhur me Raportin e Punës së Komisionit për vitin 2013, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë:

P e r f u n d i m

Miratohet Raporti i punës së Komisionit për Punë të Jashtme për vitin 2013.

4. Shqyrtimi i Planit dhe Programit të Punës së Komisionit, për vitin 2014.

Albin Kurti në Planin dhe Programin e Punës së Komisionit për vitin 2014, tha se në periudha mujore për tërë vitin janë propozuar aktivitetet e Komisionit, në të cilin në mes tjerash janë paraparë tri raportime të ministrit të jashtëm, dy raportime të ministrit të diasporës dhe një raportim i zëvendëskryeministrit Behgjet Pacolli.

Donika Kadaj - Bujupi theksoi se një pjesë e objektivave të Planit të Punës për vitin 2014, janë të pavarura, ndërsa një pjesë tjetër e tyre kërkojnë bashkërendim të veprimeve edhe me institucionet e tjera relevante, në mënyrë që të mundësohet zbatimi i plotë i planit. Ajo përkrahu Planin dhe Programin e Punës së Komisionit për vitin 2014.

Hydajet Hyseni lidhur me Planin e Punës, tha se do të ishte mirë të theksohet më shumë nevoja që të fokusohemi më tepër në procesin e integritetit të Kosovës, e veçanërisht në integritimin interparlamentar, në shqyrtimin e raporteve për Kosovën, formimin e grupeve të miqësisë si dhe në shqyrtimin e projektligjeve nga këndvështrimi i Komisionit për Punë të Jashtme.

Skender Hyseni theksoi se KPJ, është marginalizuar tërësisht nga politika e jashtme e Republikës së Kosovës, madje, tha ai se tingëllon fyese kur anëtarët e Komisionit ftohen me një ftesë të përgjithshme për të qenë spektatorë në ndonjë debat që organizon MPJ-ja. Po ashtu, theksoi se është e papranueshme, që deputetët të mos jenë të pranishëm herë pas here me institucionet e vendit, në disa nga komisionet e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Propozimi për raportim të ministrit të jashtëm në muajin mars, për përmbushjen e veprimeve nga Plani i veprimit për negocimin e MSA-së, tha se ka të bëjë fare pak me MPJ-në, duke pasur parasysh politikën e neutralitetit të BE-së, ndaj statusit të Kosovës.

Albin Kurti sa i përket formimit të grupeve të miqësisë, theksoi se Komisioni i ka propozuar Kryesisë së Kuvendit formimin e grupeve të miqësisë dhe se tani pritet që shefat e grupeve parlamentare të propozojnë deputetët për ato grupe të miqësisë. Duke u ndërlidhur me pikën për raportimin e ministrit për përmbushjen e veprimeve nga Plani i veprimit për negocimin e MSA-së, ai tha se e ka parë të nevojshme, që çështjen e integritimeve evropiane si Komision të përpiqen të

mos e lënë të kufizuar vetëm tek MIE-ja dhe komisioni përkatës parlamentar, sepse integrimet evropiane janë edhe çështje e politikës së jashtme.

Sabri Hamiti propozoi që në Planin dhe Programin e Punës së Komisionit, në pikën e paraparë, vizitë e delegacionit të KPJ-së të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të theksohet se do të jetë me ftesë të Komisionit tonë, si dhe në pikën Kontakte me PE-në, Komisionin për Evropën Juglindore, e paraparë në muajin shkurt, të kërkohet vizitë nga delegacioni i Komisionit për Punë të Jashtme, në PE.

Pas diskutimeve të anëtarëve të Komisionit, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Miratohet Plani dhe Programi i Punës së Komisionit për Punë të Jashtme, për vitin 2014, me plotësimet që në muajin prill, tek vizita zyrtare e KPJ-së të Kuvendit të Shqipërisë të qartësohet se bëhet me ftesë të Komisionit tonë dhe pika Kontakte me PE Komisionin për Evropën Juglindore, të zëvendësohet me kërkesë për vizitë nga delegacioni i KPJ, në PE.

5. Të ndryshme

Anëtarët e Komisionit kërkuan që Rezoluta e Parlamentit Evropian, për procesin e integritimit evropian të Kosovës e datës 16 janar 2014, të përkthehet në gjuhën shqipe dhe të shqyrtohet në mbledhjen e radhës së Komisionit.

Takimi përfundoi në orën 11:45

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit